



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

---

**P nr.284/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit J.M sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.272/17 të dt.14.3.2017, për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 pika 1.1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit J.M , të dëmtuarës L. M dhe të prokurorit të shtetit Lumturije Hoxha me dt.29.1.2018 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri J. M i lindur me dt.06.3.1976 në fsh.N Komuna e P., ku edhe tani jeton, i biri I dhe nënës B e gjinisë K, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës , kinse i pa dënuar më parë , gjendet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

Për arsye se:

Me dt. 02.2.2017, rreth orës 18:00 , në fsh. N. Komuna e P. , tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore , me pasoja të përkohshme për shëndet tjetrit dhe atë të dëmtuarës ( Bashkëshortes së tij ) L. M , në atë mënyrë që pas një zënke verbale , i pandehuri e grushton disa herë në fytyrë dhe trup të dëmtuarën dhe i shkakton lëndime të lehta trupore në syrin e majtë, në hundë, në krahun e majtë dhe shpinë.

-me çka ka kryer veprë penale : lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 pika 1.1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 188 par 1 pika 1.1 të KPRK-së. **I SHQIPTON.**

**DËNIM TË KUSHTËZUAR**

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësor dhe të shpenzimeve të procedurës penale .

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.14.3.2017 kundër të pandehurit J. M ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.272/17, për vepre penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 pika 1.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarës , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme , fakti se i pandehuri është i gjendjes së varfër ekonomike dhe mbajtës i vetëm i familjes prej 6 anëtarësh por edhe faktin se i pandehuri të dëmtuarën e ka bashkëshorte dhe tani kanë raporte shumë të mira , ku e dëmtuara deklaroj se kundër të pandehurit nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensimin e dëmit , , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjyqimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.29.1.2018.

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

#### KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .